


Dokument i shkurtër i politikave

Konteksti i zhvillimit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë

Pikëpamjet e shoqërisë civile

Shtator 2013



Autor:

Florian Qehaja

Ekipi Hulumtues:

Fjolla Raifi

Skender Perteshi

Ky dokument i politikave është hartuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

Realizimi i këtij projekti është mbështetur nga Projekti për Kontroll Demokratik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë i Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH).

QKSS mbanë përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij publikimi. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

© Të drejtat autoriale:

Të gjitha të drejtat e distribuimit të këtij raporti janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Konteksti i zhvillimit strategjik e doktrinar në sferën e sigurisë në Kosovë

Sektori i sigurisë në Kosovë ka qenë kompetencë e rezervuar e bashkësisë ndërkombëtare që nga përfundimi i konfliktit i vitit 1999, si dhe vendosjes së prezencës civile dhe ushtarake ndërkombëtare në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe roli i institucioneve vendore në ndërtimin e institucioneve të sigurisë në Kosovë ka qenë inekzistent, në përjashtim të rolit të vendorëve në demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), që mbikëqyrej nga UNMIK-u dhe i raportonte atij.

Sidoqoftë, deri në vitin 2004, pronësia lokale në zhvillimin e sektorit të sigurisë vështirë që ishte parashtruar si çështje, e ndërkohë autoritetet e UNMIK-ut shprehën shumë pak (nëse jo aspak) gatishmëri për transferimin e kompetencave në fushën e sigurisë tek vendorët. Me fjalë të tjera, ka pasur fare pak ose aspak 'zë vendor' në konsolidimin e sektorit të sigurisë në Kosovë.¹

Bashkësia ndërkombëtare vazhdimisht kishte hezitur t'i transferonte përgjegjësitë në mënyrë efikase tek vendorët, së

¹ QKSS- "Analiza e Kontekstit për Reformimin e Sektorit të Sigurisë në Kosovë"- faqe 9
<<http://www.qkss.org/repository/docs/KOS - KCSS shqip final 325152.pdf>>

pari sepse kishte shumë pak besim, si dhe në anën tjetër u orientua që shumë shpejtë të ndërtojë një sektor të sigurisë duke u bazuar në "përvojat dhe shembujt e vendeve tjera" të cilat jo gjithmonë kanë qenë në përputhje me kontekstin vendor, dhe nivelin e demokratizimit dhe ndjeshmërinë e rrethanave në Kosovë. Ka pasur mungesë të dëgjimit të 'zërave vendorë' në zhvillimet e përgjithshme të sektorit të sigurisë.²

Protestat e paparashikuara dhe të dhunshme të Marsit 2004, nxorën në pah gatishmërinë dhe kapacitetet e limituara të UNMIK-ut dhe KFOR-it për tu ballafaquar me protestat e dhunshme, si dhe nevojën për ndryshimin e arkitekturës së sigurisë në Kosovë, dhe si rrjedhojë filloi edhe Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS) në Kosovë i iniciuar bashkërisht nga UNMIK dhe Qeveria e Kosovës në vitin 2005. Vlen të theksohet se ngjarjet e Marsit 2004, paradoksalisht, ishin katalizator i ndër-veprimeve UNMIK-Qeveri e Kosovës duke filluar një fazë të re në sektorin e sigurisë. Gjatë procesit të RBSS në Kosovë ishin të përfshirë zyrtarë të lartë të UNMIK-ut, Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të partive politike në Kosovë, dhe atyre të komuniteteve. Ky ishte aktiviteti i parë i rëndësishëm në sektorin e sigurisë ku institucionet vendore edhe pse me kompetenca shumë të vogla në sektorin e sigurisë, janë të

² Po aty, faqe 10

përfshira në mënyrë direkte në zhvillimin e sektorit të sigurisë në vend.

Qëllimi i RBSS ishte vlerësimi i përgjithshëm i sfidave të Kosovës rreth kërcënimeve dhe rreziqeve qoftë politike apo ekonomike, të cilat i kanosen vendit, si dhe nxjerrjen e rekomandimeve me qëllim të përballimit të sfidave dhe rreziqeve të cilat dalin nga procesi i RBSS. Gjithashtu me anë të RBSS parashikohej edhe fillimi i transferimit të kompetencave të sektorit të sigurisë tek vendorët.

Mos transferimi i kompetencave në fushën e sigurisë në Kosovë nga ana e prezencës ndërkombëtare e pamundësoi ndërtimin e institucioneve të mirëfillta të sigurisë, e cila krijoi një vakum dhe si rrjedhojë, shpallja e pavarësisë së Kosovës sfidoi institucionet e sigurisë me një mandat të shtuar dhe kompetenca shtesë dhe të cilat ishin totalisht të papërgatitura për tu ballafaquar me situata si: luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, apo trafikimit me qenie njerëzore që deri në këtë kohë ishin kompetencë ekskluzive e policisë së UNMIK-ut. Për më shumë, kjo qasje e faktorit ndërkombëtar e pamundësoi edhe ushtrimin e kontrollit civil dhe demokratik të sektorit të sigurisë.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe miratimit të Kushtetutës së Kosovës lindi nevoja për ndryshimin e

legjislacionit dhe arkitekturën e sigurisë në Kosovë, të cilat parashiheshin me Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari. Bazuar në Kushtetutën e Kosovës, sektori i sigurisë në Kosovës përbëhet nga: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) Policia e Kosovës (PK) Agjencia e Kosovës për Inteligjencë(AKI), Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) dhe Sektori i Emergjencave Civile të cilat edhe me tutje ishin të mbikëqyrura nga prezenca ndërkombëtare në Kosovë (KFOR, EULEX dhe ICO).³

Këshilli i Sigurisë së Kosovës i cili ka mandat ligjor dhe kushtetues për hartimin e të gjitha politikave të sigurisë së Kosovës duke përfshirë edhe hartimin e strategjisë nacionale të sigurisë filloi përgatitjet për hartimin e strategjisë së sigurisë së Kosovës në vitin 2009. Sekretariati i KSK i koordinoi të gjitha aktivitetet në hartimin e strategjisë nacionale të sigurisë, dhe grupi punues për hartimin e strategjisë nuk kishte përfshirje shumë të madhe nga institucionet e vendit e as nga akteret e jashtëm.⁴ Grupi punues për hartimin e strategjisë përkundër involvimit shumë të madh nga ana e prezencës

³ Plani Gjithëpërfshirës i Presidentit AHTISARI për Statusin Final të Kosovës-Sektori i Sigurisë në Kosovë, faqe 48. <http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf>

⁴ Florian Qehaja -Drejtor Ekzekutiv në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë ka qenë i involvuar në Grupin Punues për hartimin e Strategjisë Nacionale të Sigurisë së Kosovës në vitin 2009.

ndërkombëtare në Kosovë arriti ta finalizojë draftin e strategjisë nacionale të sigurisë, por si i tillë ky dokument më vonë u imponua nga faktori ndërkombëtar në Kosovë, më konkretisht Ekipi Këshillëdhënës për Siguri në kuadër të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO)⁵ përmbajtja e të cilit aspak nuk ndërlidhej më kontekstin real në vend, dhe nuk i adresonte sfidat reale të sigurisë me të cilat përballlej Kosova. Kjo strategji e imponuar nga prezenca ndërkombëtare në Kosovë u miratua në Kuvend pa ndonjë debat publik apo parlamentar, dhe në përmbajtjen e saj nuk kishte të paraparë asnjë kërcënim nacional me të cilin mund të përballlej vendi, si dhe në përgjithësi ky dokument nuk i ngjante një dokumenti të sigurisë nacionale.

Rrjedhimisht, elementet kryesore të këtij procesi, përfshirë transparencën dhe debatin publik, përfshirjen e përgjithshme institucionale dhe të grupeve të interesit si dhe kohëzgjatjen, nuk arritën të konstituonin një proces të mirëfilltë.

I. Bazat Politike dhe Kushtetuese për lansimin e RSSS

⁵ Zyra Civile Ndërkombëtare në Kosovë (ICO) kishte mandatin të mbikëqyrte pavarësinë e Kosovës, domethënë të kujdesej që Plani i Ahtisaarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës të zbatohet në tërë territorin e vendit, i cili duhej integruar në sistemin juridik të shtetit.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës më 21 Mars 2012⁶ për miratimin e nismës për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), u pasua me një mori zhvillimesh të cilat afektuan bazën ligjore të RSSS, pronësinë vendore si dhe transparencën e procesit dhe (mos)angazhimin e akterëve jo-qeveritarë. Duke synuar të përmbush disa qëllime ambicioze politike dhe ligjore, 4 vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, RSSS si qëllim primar synon ndryshimin e mandatit aktual të Forcës së Sigurisë së Kosovë (FSK) dhe të Ministrisë së FSK – pavarësisht që ky synim nuk është reflektuar në vendimin përkatës të Qeverisë për shkak të ndjeshmërisë politike ndërkombëtare dhe konstelacionit të forcave brenda shteteve anëtare në NATO dhe status-neutralitetit të adoptuar nga 2008.⁷ Megjithatë, vetë fakti që ky proces në mënyrë eksplicite udhëhiqet nga Komiteti Drejtues i drejtuar nga Ministri i FSK-së,⁸ tregon për rëndësinë që ky proces ka synuar t'i kushtoj në veçanti të ardhmes të FSK-së.

Mbi të gjitha, vlen të theksohet se RSSS u iniciua si rezultat i nevojës së institucioneve vendore të sigurisë për të marrë kompetenca shtesë pas kërkesës që

⁶ Vendimi i Qeverisë së Kosovës për fillimin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë në Kosovë. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/vendimet_e_mbl_6_3.pdf>

⁷ Po aty, pika 1 deri në 1.8;

⁸ Po aty, pika 3 dhe 4.

derivonte nga Plani i Ahtisarit për rishikimin e mandatit të FSK-së;⁹ si dhe nevojës për hartimin e strategjisë së re nacionale të sigurisë që do ta zëvendësonte Strategjinë së Sigurisë së Kosovës të vitit 2009. Paralelisht, viti 2012 rezultoi me agjendën e Përfundimit të Mbikëqyrjes së Pavarësisë dhe mbylljen e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) më 10 Shtator 2012 bazuar në Pakon e Presidentit Ahtisari. Megjithatë, ky vendim i Kuvendit të Kosovës përveç që krijoi një realitet afirmativ të ri politiko-kushtetues, po ashtu krijoi edhe dilema të reja në pamundësinë e mbylljes së pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe civile në Kosovë bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Largimi i ICO-së nga peizazhi institucional i Kosovës nuk ndikoi fare në vazhdimin e funksionimit të KFOR-it me një prezencë solide me rreth 5, 000 trupa si dhe ushtrimin e disa kompetencave ekzekutive të EULEX-it në fushën e sundimit të ligjit, duke përbërë kështu pjesën më delikate të ushtrimit të sovranitetit të plotë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga institucionet ndërkombëtare, përkatësisht NATO (KFOR) dhe BE (EULEX).¹⁰

⁹ Plani Gjithëpërfshirës i Presidentit AHTISARI për Statusin Final të Kosovës-Spektori i Sigurisë në Kosovë, faqe 48. <http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf>

¹⁰ Shkëmbimi i letrave mes Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri gjatë

Për më tepër, me amendamentimet kushtetuese,¹¹ Kosova mbeti nën një dualizëm kushtetues dhe ligjor sa i përket dispozitave të cilat qenë fshirë/larguar nga Kushtetuta e Kosovës pas vendimit të Kuvendit, përkatësisht Neni 153, kapitulli për Praninë Ndërkombëtare Ushtarake.¹² Në një interpretim të thjesht, aktualisht kjo prezencë ndërkombëtare nuk ka bazë ligjore në Kushtetutën e Kosovës, të cilën e ka pasur deri më 7 Shtator 2012. Aktualisht, bazuar në dispozitat kushtetuese Kosova njeh vetëm këto institucione në sektorin e sigurisë: FSK, Policia e Kosovës (PK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK), dhe Sektori i Emergjencave Civile.

Në këtë konstelacion të zhvillimit të RSSS, viti 2012

vitit 2012 rreth pranisë së EULEX-it dhe vazhdimin të mandatit deri në Qershor 2014, ishte vetëm ishte konfirmim dhe mirëkuptim se Kosova pranon të bashkëpunojë me këtë të fundit, pavarësisht bazës juridike që buron nga Rezoluta 1244 e KS-OKB.

¹¹ Pika 1.7 e Vendimit të Qeverisë Nr.09/67 kërkon që të ndryshohet i tërë kuadri ligjor në bazë të rekomandimeve të RSSS-së. Por kjo pikë nuk sqaron nëse kemi të bëjmë edhe me ndryshimin e dispozitave kushtetuese aktuale të rreth FSK-së, përkatësisht Neni 126.

¹² Shiko dokumentin mbi Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare me 7 Shtator 2012 http://www.md-ks.org/repository/docs/Ligji_per_amandamentimin_e_Kushtetutes_se_Republikes_s_e_Kosoves_%28shqip%29.pdf

koincidoi edhe me agjendën e bisedimeve teknike dhe fillimit të bisedimeve të nivelit të lartë mes dy Kryeministrave në Bruksel, si dhe me përpjekjet e Qeverisë së Kosovës që të fillojnë me integrimin gradual të komunave veriore përmes shthurjes dhe transformimit të strukturave paralele dhe ilegale të sigurisë serbe që operojnë në atë hapësirë që nga viti 1999.

Po ashtu, gjatë vitit 2013 RSSS vazhdoi të sfidohej kryesisht nga kontinuiteti i agjendës së dialogut në Bruksel dhe adresimin e tendencës të qeverisë serbe për të mos lejuar praninë e FSK-së dhe 'pasardhëses' së këtij institucioni në komunat veriore të Kosovës. Qershori i vitit 2013 nuk solli përfundimin e këtij procesi, ashtu siç kërkohet me pikën 2 të vendimit të Qeverisë rreth RSSS, dhe as qëllimin kryesor – ndryshimin e mandatit aktual të FSK-së. Përveç konfirmimit nga Këshilli Veri-Atlantik rreth deklarimit të Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO) për FSK në muajin Korrik – një vendim ky i pritur por i vonuar në raport me dinamikën e paraparë. Madje as edhe një raport preliminar i RSSS nuk ishte prodhuar, pavarësisht deklaratave të Ministrit të FSK-së në mbledhjen e Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.¹³

¹³ Mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, datë 26.03.2012, me ç'rast

II. Baza Ligjore për RSSS

Vlen të theksohet se që nga inicimi i këtij procesi, vetëm vendimi i Qeverisë Nr. 09/67 datë 21 Mars 2012 është i publikuar dhe ka qasje për publik. Ky vendim, përveç Komitetit Drejtues themeloi edhe Grupin Kordinues Ndërmnistror dhe Koordinatorin, Grupet Punuese brenda ministrive/agjencioneve pjeëmarrëse në proces, Sekretariatit e procesit dhe Zëdhënësin. Megjithatë, deri më tani nuk është vëzhguar ndonjë zyrtar qeveritar i cili ka pranuar të deklarohej për këtë proces përveç Ministrit të FSK-së. Prandaj, baza ligjore për RSSS kryesisht bazohet tek një vendimi qeveritar, kurse diskutabile mbetet kërkesa për nxjerrjen e Strategjisë së re të Sigurisë Kombëtare të Kosovës, përkatësisht pika 1.6 e vendimit të lartpërmendur. Në veçanti, kjo dilemë derivon nga fakti se me Kushtetutën e Kosovës, neni 127 në mënyrë eksplicite obligon që këtë strategji të hartojë Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) në bashkëpunim me Presidentin dhe Qeverinë.

Po ashtu, Strategjia e Sigurisë së Kosovës kërkohet edhe me Ligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, neni 2.1 e cila pastaj duhet të dërgohet tek Kuvendi i Kosovës për miratim. Rol të veçantë në këtë proces do të duhej të kishte Sekretariati i KSK-

Ministri i FSK-së, kishte raportuar për gjendjen dhe objektivat e FSK-së gjatë këtij viti.

së i cili sipas ligjit në fjalë obligohet të bëj koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë. Por vendimi respektiv i Qeverisë së Kosovës, pika 5.6 përveç që Sekretariatit e KSK si anëtarë të barabartë në Komitetin Drejtues,¹⁴ i jep rol menaxhues/koordinues dhe logjistik si sekretariat i RSSS-së bazuar në pikën 8.

III. Pronësia vendore në procesin e zhvillimit strategjik

Për dallim nga dy proceset e kaluara të vitit 2006 dhe 2009, RSSS deri në këtë fazë është pothuajse diametralisht i ndryshëm qoftë në aspektin e vendim-marrjes politike apo edhe në dizajnimin e metodologjisë dhe qëllimeve. Megjithatë, që nga 2012 RSSS është duke u implementuar nga ekipi këshillues i nivelit strategjik nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës - DIRI (Defense Institute Reform Initiative apo Iniciativa për Reformë e Institutit të Mbrojtjes), i cili ka qenë i mandatuar të mbajë punëtori ndër-institucionale gjatë të cilave do të duhej të prodhoheshin produkte specifike për secilën fazë të caktuar të procesit. Specifikisht, pika 7.6 e

vendimit të qeverisë për procesin e rishikimit parashihet edhe angazhimi i ndonjë institut apo organizatë vendore apo ndërkombëtare për ndonjë çështje të caktuar nëse e shohin të nevojshme.” Edhe pse mund të thuhet që kjo pikë është përmbushur, është evidente se ka munguar një qartësi procedurale se si ky institut apo organizatë do të selektohej dhe angazhohej në proces. Paradoksalisht, për dallim nga pika e lartpërmendur, pika 8.3 e vendimit pothuajse paragjykon që instituti duhet të jetë ndërkombëtarë, si vijon: “të jetë lidhja përgjegjëse në mes të Komitetit Drejtues, Institutit Ndërkombëtarë të Hulumtimit dhe Grupeve Punuese Ministrore.”

Thënë më qartë, pika 7.3 nuk ka krijuar rrethana dhe proces konkurrues kurse përparësi i është dhënë vetëm atyre ndërkombëtare. DIRI ka funksionuar përmes vajtje-ardhjeve dhe me një ekip kryesisht i orientuar në çështjet e politikave shtetërore. Deri më tani nuk është vërejtur ndonjë përpjekje serioze e këtij instituti që të pranojë perspektivën dhe inputet e shoqërisë civile në RSSS.

IV. Transparenca e procesit dhe angazhimi i akterëve jo-qeveritar

¹⁴ Së bashku me Ministrin e Punëve të Brendshme; Punë të Jashtme; Drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës; Këshilltarin për Siguri të Kryeministrit; Komandanti i FSK-së; Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe Drejtori i Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave.

Krahas përmbajtjes së strategjisë, bazës ligjore, si dhe procesit të zhvillimit strategjik, po me aq rëndësi të madhe është edhe transparenca e gjithë procesit të hartimit dhe angazhimi sa më i gjerë i akterëve jo-qeveritarë që nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në institucionet qendrore. Sa më gjithëpërfshirës të jetë procesi i hartimit të kësaj strategjie aq më transparent dhe i zbatueshëm do të jetë në praktikë. Një proces transparent gjithashtu parandalon interesat individuale të anëtareve të grupit punues, duke vënë në dukje qëllimin e produktit final të procesit.¹⁵

Duke qenë se procesi i rishikimit ka filluar që nga miratimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës në Shkurt 2012, diskutimi mbi këtë proces është potencuar vetëm në mbledhjet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me përfundimin e vitit 2012, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) raportoi para Komisionit përkatës për të arriturat dhe aktivitet e FSK-së gjatë vitit 2012 si dhe parashitjet e gjitha objektivat për vitin 2013. Para së gjithash, ministri potencoi preokupimin e FSK-së me RSSS në Kosovë dhe rolin e saj në këtë proces¹⁶.

¹⁵ Forumi për Siguri, "Procesi i hartimit të Strategjisë së re të Kosovës", Maj 2013.

¹⁶

<http://www.kuvendikosoves.org/common>

Duke qenë se mbledhjet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrjen e FSK-së janë të hapura për palët e interesuara, raportimi edhe për çështjen e procesit të rishikimit konsiderohet që është bërë me transparencë dhe në mënyre të hapur për publikun. Megjithatë, raportimi i MFSK mbi mbarëvajtjen e procesit të RSSS nuk ka rezultuar në ndonjë diskutim thelbësorë ose shkëmbim idesh. Në fakt, raportimi mbi procesin e rishikimit ka qenë si pjesë e raportimit të përgjithshëm që MFSK ka bërë për aktivitetet e saja të vitit 2012 në komisionin mbikëqyrës parlamentar i cili ka mandatin për kontroll dhe mbikëqyrje demokratike ndaj institucioneve të sigurisë, dhe, si rrjedhojë, diskutimi i hapur për publikun i paraparë në vendimin për RSSS ende nuk ka ndodhur.

Diskusimi më transparent konsiderohet të jetë organizimi i drejtorisë për Politika dhe Plane të MFSK-së me temën *Misioni i FSK-së, dhe Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë së Kosovës*, ku të ftuar përveç përfaqësuesve të lartë të MFSK-së ishin edhe përfaqësues të ambasadave të huaja në Prishtinë, përfaqësues të Shoqërisë civile, si dhe të Organizatave vendore dhe ndërkombëtare për siguri¹⁷. Përveç shumë tema të tjera si misioni dhe

/docs/proc/proc_2013_03_26_10_4834_al.pdf

¹⁷ <http://mksf-ks.org/?page=1,24,652>

roli i FSK-së e bashkëpunimi rajonal, procesi i RSSS ishte njëra ndër temat kryesore dhe më e diskutuar. Diskutimin e ndihmuan me eksperiencën dhe njohuritë e tyre edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Megjithatë, fakti se në këtë takim kishte përfaqësues të pranisë ndërkombëtare dhe përfaqësive diplomatike nuk e bënte këtë takim një diskutim tërësisht me shoqërinë civile.

Takimi i dyte në të njëjtin format ishte planifikuar të mbahej në qershor 2013 me qëllim të ri-adresimit të çështjeve me rendësi të diskutimit paraprak, mirëpo ka dështuar si rrjedhojë e mos-pjesëmarrjes së të ftuarve relevant në takim. Në këtë takim kishte prezencë të vetëm dy hulumtuesve të QKSS.

Diskutimet më të gjera lidhur me FSK-në u bënë gjatë konferencës së organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në kuadër të platformës "Forum 2015" me temën *‘Çka tutje me FSK: Ushtri apo jo?’*¹⁸. Konferenca ka trajtuar gjetjet e një dokumenti të politikave të punuar nga QKSS lidhur me të ardhmen e FSK-së të paraqitur në tri skenarë të mundshme¹⁹. Konferenca ishte e përfaqësuar nga të gjithë akterët relevantë në vend, qoftë nga sektori

qeveritar ashtu edhe nga ai jo-qeveritar. Në fakt, kjo konferencë ishte e para e këtij lloji ku tema mbi procesin e rishikimit dhe të ardhmen e FSK-së të hapej para një audience më të gjerë në të cilën të gjithë akterët e shoqërisë civile kishin mundësinë e komentimit një çështjeje në interes të sigurisë së Kosovës. Konferenca arriti kulmin e impaktit si rrjedhojë e adresimit në media të stafit të QKSS për RSSS si dhe senzibilizimit të kësaj çështjeje në opinionin publik.

Sfidat kryesore

RSSS vazhdon të sfidohet nga varësia e agjendës politike në trekëndëshin Prishtinë-Bruksel-Beograd, si dhe nga mungesa e afateve të qarta të cilat do të kishin mundësuar një proces më të qartë. Mos-zbatimi i Vendimit të Qeverisë, ndryshimi i roleve institucionale dhe përgjegjësive përkatëse si dhe një ndarje e zbehtë e detyrave ndër-ministore rrezikon të prolongojë edhe më tutje këtë proces strategjik.

Po ashtu, mungesa e ekspertizës institucionale, sidomos në institucionet që janë të lidhura në mënyrë indirekte me sektorin e sigurisë brenda RSSS; mungesa buxhetore apo mos-ekzistimi i një fondi të deleguar në këtë proces sipas Vendimit të Qeverisë, pika 9, si dhe mungesa e bashkëpunimit

¹⁸

<http://www.qkss.org/sq/Lajme/Konferen ce-Cka-tutje-me-FSK-Ushtri-apo-jo-164>

¹⁹ http://www.qkss.org/repository/docs/%C3%87ka_tutje_me_FSK-Ushtri_apo_je_445006.pdf

dhe impenjimit mes ministrive të linjës kanë sfiduar seriozisht procesin e RSSH. Për më tepër, ky proces nuk ka siguruar deri në këtë fazë një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente ku shoqëria civile, ekspertë të pavarur dhe media të marrin pjesë dhe të jenë të angazhuar aktivisht.